

“Dhuro duke Vrapuar” ishte motoja e aktivitetit sportiv të realizuar më 29 maj 2016, ku ishin të ftuar të gjithë ata që mund të vraponin nga Pedonalja deri në Shirokë.

Ky aktivitet sportiv u organizua nga Konsullata Hungareze në Shkodër dhe Shkodra Tenis, mbështetur nga Bashkia Shkodër, Shkodra Travel, Harmonia Grup, Radio Vintage, Water Sports, Universiteti i Shkodrës – Dep. Fizkulturës, Novartis, Organizata Shqiptare e Urdhrit të Maltës, Lufa Studio, Drejtoria Arsimore Shkodër, Polica e Shtetit. Të gjitha të ardhurat e mbledhura nga ky aktivitet iu dhuruan Shtëpisë së Fëmijës në Shkodër.

Organizata Shqiptare e Urdhrit të Maltës ishte e pranishme në këtë aktivitet pas kërkesës së kryetares së Bashkisë Shkodër, Znj. Voltana Ademi, për të asistuar me skuadrën e Ndhmës së Parë dhe për të garantuar ndihmën mjekësore.

